



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr.181/6 prot.

Tiranë, 10.4.2019

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 103, datë 5.2.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Donika Prele.
- Baza Ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, Neni C, pika 2, Neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese.
- Për dajeni:** Operacionit Ndërkombëtar i Monitorimit.
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datë 27.3.2019, është njoftuar vendimi nr. 103 datë 5.2.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin në rivlerësim znj. Donika Prele, prokurore/drejtuese në Prokurorinë e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor, nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr.103, datë 5.2.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Donika Prele, ushtron detyrën e prokurores/drejtuese në Prokurorinë e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit

të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si *DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Grupi i Punës i Prokurorisë së Përgjithshme (në vijim referuar si *GPPP*), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Donika Prela”, ka referuar se:

- i. Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës, ka referuar: “Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës” për subjektin.

2.3 GPPP, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale.

3. Komisioni pas hetimit administrativ dhe vlerësimit të fakteve dhe rrethanave lidhur me kontrollin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, për secilin kriter, në mënyrë të përmbledhur ka arritur në përfundimet si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë**, bazuar në nenin D, të aneksit të Kushtetutës dhe kreun IV, të ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ ka konsistuar në kontrollin dhe vlerësimin e saktësisë, mjaftueshmërisë së deklaramit dhe burimin e ligjshëm të pasurisë dhe të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të. Gjatë hetimit, veç pyetjeve dhe kërkimit të shpjegimeve nga ana e subjektit, për disa çështje ka rezultuar se provat dhe faktet e dala kanë nivelin e provueshmërisë sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, shkak për të cilin subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës, në bazë të nenit Ç, pika 5, si dhe nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën për çështjet si vijon:

3.1.1 Lidhur me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave dhe justifikimin e shpenzimeve, për periudhën 2003-2008 dhe 2010-2011.

- Gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se për të ardhurat e deklaruara për të gjithë periudhën e punësimit të z.***.***, në shoqërinë “****” sh.p.k., nuk ishin paguar të plota sigurimet shoqërore dhe tatimet;

- Nga hetimi i kryer lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet, ka rezultuar se nuk justifikohen me të ardhura të ligjshme (për të cilat janë paguar detyrimet tatimore), shpenzimet e kryera për periudhën 2003-2008 dhe 2010-2011.

3.1.2 Lidhur me mundësinë e shtetasit ***.***. për të dhënë hua shumë 15,000 euro, shumë e cila ka shërbyer si burim për pasurinë nr. 1, apartament banimi me sip. 95.6 m², i ndodhur në Tiranë.

- Gjatë hetimit administrativ mbeti e paprovuar marrëdhënia e huasë në kuptim të mundësive që ka patur zoti ***.***. për dhënie e kësaj shume hua;

- Subjekti i rivlerësimit ka patur detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj shume nga huadhënësi sipas nenit 32 pika 4 të ligjit nr. 84/2016;

3.1.3 Në këto kushte, subjekti ka pasur detyrimin për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit mbi mungesën e burimeve financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit, pasuri nr.1.

3.2 Komisioni, pas administrimit dhe vlerësimit të pretendimeve dhe provave të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën në lidhje me sa iu kalua barra e provës, në vendimin e tij ka arsyetuar se: “... Nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht. Deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin me burime financiare të ligjshme. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezulton të jetë e ligjshme, nuk ka deklarim të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk ka kryer fshehje të pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.”

4. Për kontrollin e figurës, bazuar në nenin DH të aneksit të Kushtetutës dhe kreun V të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi administrativ i Komisionit nuk janë gjetur elementë që të vërtetojnë apo ngrenë dyshime të arsyeshme mbi kontakte të papërshtatshme të subjektit. Sipas Komisionit, subjekti është gjendur në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës.

5. Për vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në nenin E të aneksit të Kushtetutës dhe kreun VI të ligjit nr. 84/2016, Komisioni pas administrimit dhe analizimit të raportit të përgatitur nga GPPP, i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit pasi për dy nga pesë dosjet penale të përzgjedhura, megjithëse kanë pasur për objekt të njëjtën vepër penale, atë të drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt (neni 291 i Kodit Penal) dhe rrethanat paraqiten të ngjashme është konstatuar se janë ndjekur standarde të ndryshme procedimi.

5.1 Komisioni, pas administrimit dhe vlerësimit të shpjegimeve të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se: “... rezulton se në rastin konkret nuk janë zbatuar standarde të ndryshme për raste të ngjashme, pasi për shtetasin ***.***. nuk gjen zbatim dispozita e nenit 258 të K.Pr.Penale.¹”. Komisioni në vlerësim të këtij kriterit ka krijuar bindjen se subjekti ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

6. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, bazuar në nenin 4 pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka vendosur:

- Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Donika Prela, me funksion prokurore/drejtuese në Prokurorinë e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

II. Shkaqet e ankimit

- 7.** Në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet që kryejnë procesin e rivlerësimit kalimtar (Vetting).
- 8.** Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).
- 9.** Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç, i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48 – 52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit.
- 10.** Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, në gjendjen që janë aktet, duke vlerësuar nëse

¹ Për më tepër referoju fq. 17-18 të vendimit të Komisionit.

vendimmarrja është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

11. Në referencë të zbatimit të dispozitave përkatëse të Kushtetutës dhe ligjit të posaçëm, Komisioneri Publik vlerëson se vendimi nr. 103, datë 5.2.2019 i Komisionit është i cënueshëm në tërësinë e tij, shkak për të cilin i kërkohet Kolegjit, të ushtrojë juridiksionin e tij kontrollues dhe rivlerësues, duke e ndryshuar atë.
12. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës si dhe nenit 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ankimon vendimin nr. 103, datë 5.2.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

II.A Vlerësimi i pasurisë

13. Përsa i takon rivlerësimin të kriterit të pasurisë, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (Vetting dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.
14. Si një ndër tri kriteret e procesit të rivlerësimit kalimtar, kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë e gjejmë të materializuar në nenin D, të aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30 – 33, të ligjit nr. 84/2016.
15. Subjekti i rivlerësimit, si subjekt mbartës i detyrimit për deklarim periodik të interesave pasurore në ILDKPKI, ka deklaruar pasuritë dhe interesat private për herë të parë në vitin 2004 (për vitin 2003), e në vijim deklaratat periodike për vitet 2004 – 2016 (referuar si Deklaratat Vjetore/DV), dhe në deklaratën “vetting” dorëzuar në ILDKPKI në datë ***.1.2017.
16. Referuar deklaratave periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016, deklaratës “vetting”, rezultateve të hetimit administrativ, akteve të administruara dhe përfundimeve të arritura nga Komisioni, Komisioneri Publik, në rastin konkret konstaton se subjekti i rivlerësimit edhe pas kalimit të barrës së provës nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, që në kuptim të nenit D, paragrafi 3, 5 i aneksit të Kushtetutës, do ta bënte atë subjekt të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, e për pasojë të sillte konfirmimin e saj në detyrë.
17. **Për pasurinë nr. 1, apartament banimi me sip. 95.6 m², i ndodhur në Tiranë.**

17.1 Në deklaratën “vetting”, subjekti ka deklaruar pasurinë: Apartament banimi me sipërfaqje 95.6 m², regjistruar në hipotekë me numër pasurie ***, me numër hipoteke *** datë ***.11.2012 në emër të bashkëshortit ***.***.

17.2 Burimi i krijimit: (i) të ardhurat e përbashkëta të krijuara nga puna si prokurore dhe e bashkëshortit ***.*** gjatë viteve 2006, (kursime të deklaruara 1.000.000 lekë), (ii) të ardhura të përbashkëta nga puna gjatë vitit 2007, si dhe (iii) hua e marrë nga shtetasi ***.***, djali i xhaxhait të bashkëshortit në shumën 15.000 euro, me kontratë verbale. Huaja në shumën 15.000 euro është likujduar në dy këste, 7.500 euro në vitin 2008 dhe 7.500 euro në vitin 2009, nga të ardhurat e krijuara nga puna si prokurore dhe e bashkëshorti ***.*** për vitet 2008-2009.

17.3 Në DV 2007, subjekti ka deklaruar: Blerje apartament banimi 2+1. Kontratë porosie datë ***.5.2007 në emër të ***.***, e pahipotekuar, vlera 32.100 euro. Hua e marrë për blerje apartamenti në shumën 15.000 euro, kontratën verbale me afat 3 vjeçar marrë nga shtetasi ***.***.

17.4 Komisioni gjatë hetimit administrativ mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, ka konstatuar se për vitet 2003-2008, nuk janë paguar të plota sigurimet shoqërore dhe detyrimet tatimore mbi të ardhurat e bashkëshortit, si dhe nuk provohet marrëdhënia e huasë në kuptim të mundësive që ka patur z. ***.*** për dhënien e kësaj huaje, në cilësinë e personit tjetër të lidhur.

17.5 Pasi ka administruar provat dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni ndër të tjera ka konkluduar se: “... shtetasi ***.*** vërtetoi në mënyrë të pakontestueshme se marrëdhënia e tij e punësimit është e ligjshme dhe të ardhurat e përfituara kanë qenë nga një marrëdhënie pune e ligjshme. Mospagimi i taksave për një pjesë të të ardhurave në shumën totale prej 2,584,910 lekë ka qenë detyrim i punëdhënësit dhe se ato nuk mund të paguheshin nga vetë subjekti... Subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm faktin se nuk ka pasur dijeni për këtë praktikë të punëdhënësit dhe se bashkëshorti i saj nuk ka bashkëpunuar me punëdhënësin për të shmangur pagimin e detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, porse ai ka qenë i dëmtuar nga ky proces.”

17.6 Ndërsa për burimin e ligjshëm dhe mundësinë e shtetasi ***.*** për të dhënë huanë, Komisioni ka krijuar “...bindjen se shtetasi ***.*** ka patur mundësi financiare nga burime të ligjshme për huanë e dhënë në shumën prej 15,000 euro bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.”

18. Komisioneri Publik, duke iu referuar përmbajtjes së fjalisë së dytë, të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës “...Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore...” çmon se për qëllim të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë, si të ardhura të ligjshme duhen konsideruar vetëm të ardhurat të cilat plotësojnë në mënyrë kumulative këto dy kritere (i) janë deklaruar dhe (ii) për të cilat vërtetohet pagimi i detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi. Ky interpretim i përmbajtjes së nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr.84/2016, është konfirmuar tashmë edhe nga jurisprudenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, vendime të dhëna mbi ankime të Komisionerit Publik, ankime të cilat, në disa raste, janë ushtruar edhe pas shqyrtimit të rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit².

18.1 Në rastin konkret, pavarësisht pretendimeve të subjektit se paga neto e përfituar nga personi i lidhur z. ***.*** (bashkëshorti) ishte sipas vlerave të deklaruara në deklaratat periodike të këtyre viteve, si dhe në deklaratën “Vetting”, Komisioneri Publik konstaton se nisur nga parashikimi i këtyre kritereve të lartpërmendura me **natyrë kumulative**, pra të **deklarimit dhe pagimit të detyrimeve tatimore**, me qëllim legjitimimin e burimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimit mbi nivelin e besueshmërisë së pasurisë, ato nuk përmbushen. Përmbushja e këtij detyrimi (pagesa e detyrimeve tatimore) nuk kufizohet me identifikimin e subjektit mbartës së barrës fiskale, përfshirë edhe detyrimet tatimore që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës. Rezulton se këtë interpretim e ka përfshirë në vendimmarrjen e tij edhe Kolegji në vendimin nr. 4/2018 për subjektin e rivlerësimit z. ***.***, në vendimin e shkurtuar nr. 6/2019 për subjektin e rivlerësimit znj. ***.*** dhe në vendimin nr. 1/2019 për subjektin e rivlerësimit z. ***.***.

18.2 Në vështrim të sa më sipër dhe nga shqyrtimi i akteve në dosje të Komisionit, Komisioneri Publik vlerëson se, në analizën financiare, në zërin e të ardhurave, duhen konsideruar vetëm ato të ardhura për të cilat provohet (i) burimi i ligjshëm i krijimit, (ii) deklarimi i saktë dhe (iii) pagesa e detyrimeve tatimore.

² (i) Vendim nr.12/2018 të KPA-së për subjektin z. ***.***; (ii) arsyetimi i përmbledhur i vendimit nr.6/2019 të KPA-së për subjektin znj. ***.***; (iii) rekomandim nr.1086, datë 6.8.2018, për vendimin nr.46/2018 të KPK-së për subjektin z. ***.***; (iv) rekomandim nr.1003/1 prot., datë 13.7.2018, për subjektin z. ***.***.

19. Në vendimin përkatës, ka gjetur pasqyrim po ashtu edhe trajtimi nga Komisioni i elementit subjektiv të personit të lidhur/subjektit të rivlerësimit, në lidhje me dijeninë për pagesën ose jo të detyrimeve tatimore për të ardhurat e rrjedhura nga marrëdhënia e punës. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar bindshëm faktin se, nuk ka pasur dijeni për këtë praktikë të punëdhënësit së bashkëshortit të saj, për mospagimin e detyrimeve tatimore për gati të gjithë periudhën e punësimit 2003-2011. Komisioneri Publik vlerëson se, ky përfundim nuk gjen mbështetje në provat e administruara, të vëna në dispozicion nga vetë subjekti i rivlerësimit.

19.1 Nga këto akte, pjesë e dosjes hetimore të Komisionit, rezultojnë se subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka paraqitur në cilësinë e provës listë-pagesat e shoqërisë “****” sh.p.k³, të cilat rezultojnë të nënshkruara nga punëdhënësi, administratori i shoqërisë z. ***.*** dhe punëmarrësi z. ***.***, bashkëshorti i subjektit. Në kollonat përkatëse të këtyre listë-pagesave specifikohet se, paga është arkëtuar pjesërisht në llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit (*gjysma e vlerës së deklaruar si pagë neto, ku janë zbritur detyrimet tatimore për këtë vlerë*) dhe pjesërisht *cash* në arkën e shoqërisë (*gjysma e mbetur e vlerës së deklaruar si pagë neto*). Pra, kuptohet se për qëllim të detyrimeve tatimore, shoqëria në fjalë, punëdhënësi në këtë rast, ka paguar një pjesë të pagës në *cash* nëpërmjet arkës së shoqërisë dhe një pjesë nëpërmjet llogarisë bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

19.2 Nga verifikimi i të dhënave të llogarisë bankare, vërtetuar me shkresën nr.*** datë ***.4.2018 nga ***, rezultojnë se bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për periudhën dhjetor 2007- dhjetor 2008, i janë kredituar pranë kësaj banke shumat 20.700 lekë/muaj (me pagesa 15 ditore prej 10.350 lekë), të cilat ndryshojnë nga vlera e pagës prej 50.000 lekë e parashikuar në kontratat e punës me shoqërinë “****” sh.p.k, të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit dhe të deklaruara në deklaratat e interesave private/periodike.

19.3 Kjo rrethanë do të ishte e mjaftueshme për të sjellë në dijeninë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, diferencat në vlerën mes pagës mujore të kaluar përmes llogarisë bankare dhe arsyes së tërheqjes *cash* të një pjese të tyre pranë arkës së shoqërisë. Fakti që subjekti i rivlerësimit edhe gjatë procesit të rivlerësimit ka nënvizuar mospasjen dijeni të saj dhe të bashkëshortit, për këtë shmangie të pagimit të detyrimeve tatimore në marrëdhëniet e punës, në konsideratë të vlerësimit etik dhe profesional, është rrethanë që rëndon pozitën e subjektit për qëllim të procesit të rivlerësimit, në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të tri kritereve sipas nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 në lidhje me nenin 61/5 të këtij ligji, qëndrim ky i mbajtur nga Kolegji, në vendimin e shkurtuar nr. 6/2019 për SR-***.***. Nënvizojmë se në periudhën në fjalë, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e prokurores së seksionit Task Force, ku brenda juridiksionit të veprimeve procedurale/hetimit të tyre, ishte edhe hetimi i veprave penale të sferës ekonomike.

19.4 Komisioni gjatë hetimit administrativ ka konstatuar se, shtetasi ***.*** ka ndërmarrë hapa ligjorë, lidhur me çështjen e mospagesave të tatimeve, në momentin që ka marrë dijeni për këtë fakt, duke depozituar kërkesë padi pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me objekt padie: “Detyrimin e palës së paditur shoqëria “****” sh.p.k, të paguajë në emër të paditësit detyrimet e papaguara në llogarinë e DRSSH-së Tiranë dhe detyrimet tatimore”. Kjo çështje ka qenë ende në gjykim në kohën e marrjes së vendimit nga ana e Komisionit.

19.5 Në referencë të këtij arsyetimi të përdorur në vendimin e Komisionit, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, nga përmbajtja e një denoncimi publik të një portali mediatik, të dërguar nëpërmjet postës elektronike, ndër të tjerë, edhe pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë ***.4.2019, rezultojnë se Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë

³ Listë-pagesa të viteve 2007 dhe 2008.

në përfundim të gjykimit të çështjes sipas, objektit të mësipërm, me vendimin nr.***, datë ***.3.2019 (vendim ky i përcjellë nga denoncuesi pa ekstremitete formale; vula, nënshkrim, etj.), ka pushuar çështjen me arsyetimin se “... duke munguar mosmarrveshja, interesi i ligjshëm, duke qenë se ushtrimi i padisë nuk i siguron paditësit asnjë avantazh si dhe meqënëse paditësi nuk arrin të provojë faktin çënues së të drejtës së tij, padia është e papranueshme...Në këto kushte Gjykata në bazë të nenit 299/c të K.Pr.Civile duhet të vendosë pushimin e gjykimit të padisë së paditësit ***.***, **si padi pa objekt**”.

20. Në vijim të interpretimit të mësipërm, të kritereve ligjore për verifikimin e burimit të ligjshëm dhe ekzistencës së të ardhurave të ligjshme për krijimin e pasurisë nr.1, analiza financiare e hartuar nga Komisioneri Publik bazohet në vlerësimin e këtyre elementeve: (i) mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit për të realizuar kursimet e deklaruara në vitin 2006; (ii) mundësia për mbulimin e pagimit të kësteve për pasurinë nga të ardhurat e vitit 2007; (iii) mundësia e krijimit të të ardhurave nga burime të ligjshme të shtetasit ***.***, për të dhënë hua në shumën 15.000 euro si dhe mundësia e subjektit të rivlerësimit për të shlyer huanë e deklaruar me burime të ligjshme.

20.1 Për efekt të pasqyrimit të metodologjisë së ndjekur nga Komisioneri Publik në këtë analizë financiare, janë konsideruar vetëm ato të ardhura që në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës vërtetohen si të ligjshme. Shpenzimet e jetesës janë llogaritur sipas ILDKPKI-së, mbështetur në të dhënat nga INSTAT. Ndryshimi i likuiditeteve bankare është llogaritur referuar pasqyrave të lëvizjeve bankare të subjektit dhe bashkëshortit.

21. (i) **Lidhur me mundësinë financiare për të realizuar kursimet e deklaruara në vitin 2006.** Në DV 2006 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë kursime në cash në shumën 1.000.000 lekë, duke deklaruar: “...disponojmë të ardhura në lekë (KESH) të krijuara nga pagat, të padepozituara në institucionet bankare”. Këtë deklaramin subjekti i rivlerësimit e sqaron dhe në deklaramin e saj në pyetësorin nr. *** të Komisionit.

21.1 Bazuar në dokumentacionin e administruar, rezulton se të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj për vitin 2006 janë në shumën 1.006.814⁴ lekë. Nga analiza financiare rezulton se subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e deklaruara për një diferencë negative prej – 285.131 lekë (të paraqitura në tabelën nr.1).

22. (ii) **Lidhur me mundësinë e subjektit për mbulimin e pagesës së kësteve të apartamentit nga të ardhurat e vitit 2007.**

22.1 Në këtë element të deklarimit, fillimisht analizohet mundësia për kursimet në vlerën 500,000 lekë, deklaruar për periudhën deri në datë ***.5.2007⁵. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, për këtë periudhë të ardhurat familjare, të ligjshme deri në datën ***.5.2007, datë në të cilën deklarohet se është bërë pagesa e parë, llogariten në shumën rreth 408,559 lekë⁶, të cilat nuk mjaftojnë për të mbuluar shpenzimet e jetesës dhe kursimin e deklaruar me të cilin është deklaruar e paguar shuma prej 500,000 lekësh.

22.2 Për pagesën e dytë, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si e kryer në datë ***.12.2007⁷ në vlerën 5,000 euro (600,000 lekë), me burim kursimet nga pagat deri në fund të vitit 2007, rezulton se të ardhurat e ligjshme, për subjektin dhe bashkëshortin e saj

⁴ Sipas vërtetimit datë ***.1.2017 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës mbi të ardhurat neto të subjektit për vitin 2006 në shumën 826.814 lekë dhe vërtetimit nga ISSH nr. *** prot. datë ***.7.2018 mbi të ardhurat e bashkëshortit të subjektit në shumën 180.000 lekë nga shoqëria “****” sh.p.k.

⁵ Referuar përgjigjeve të subjektit në pyetësorin nr. ***.

⁶ Sipas vërtetimit datë ***.1.2017 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe vërtetimit nga ISSH nr.*** prot., datë ***.7.2018 mbi të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga shoqëria “****” sh.p.k.

⁷ Referuar përgjigjeve të subjektit në pyetësorin nr. ***.

për periudhën maj – dhjetor 2007 janë në shumën 807,318 lekë⁸. Këto të ardhura nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës dhe shlyerjen e shumës prej 5,000 euro (600,000 lekë) sipas deklarimeve të subjektit.

22.3 Sa më sipër, rezulton se, subjekti dhe bashkëshorti i saj, nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme, pagesën e shumës prej 1,100,000 lekë deklaruar⁹ si e paguar në vitin 2007 me burim të ardhurat nga paga për një diferencë negative prej - 450,240 lekë (të paraqitura tabelën nr.1)

Tabela nr. 1-Analiza financiare bazuar në të ardhurat e ligjshme, të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, për vitet 2006 - 2007.

	Viti 2006	Viti 2007
Të ardhura subjekti (I)	826,814	843,477
Të ardhura bashkëshorti (II)	180,000	372,400
Kursime te deklaruar (III)	1,000,000	1,100,000
Shpenzime jetike (IV)	540,000	540,000
Ndryshime te llogarive bankare (V)	-248,055 ¹⁰	26,117
Diferenca në mbulimin e shpenzimeve dhe kursimeve me të ardhura të ligjshme (VI=I+II-III-IV-V)	-285,131	- 450,240

23. (iii) Lidhur me huanë e marrë nga shtetasi ***.***.

23.1 Subjekti në DV 2007, ka deklaruar hua në shumën 15.000 euro, marrë nga shtetasi ***.*** më kontratë verbale, pa interes dhe me afat 3 vjeçar. Subjekti ka deklaruar se në momentin e huadhënies, bashkëshorti i saj ka lëshuar një deklaratë dore për pranimin e huasë, e cila është asgjësuar pas likuidimit të kësaj të fundit¹¹.

23.2 Për të provuar marrëdhënien e huasë, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale me nr.*** rep., nr. *** kol., e datës ***.2.2016, në të cilën shtetasi ***.*** ka deklaruar se më datë ***.5.2007 i ka dhënë hua pa asnjë lloj interesi shtetasit ***.*** shumën 15.000 euro, me afat tre vjeçar. Komisioneri Publik konstaton se kjo deklaratë noteriale është hartuar *a posteriori* (paraqitur nga subjekti gjatë procedurës së rivlerësimit) dhe nuk është mbajtur në momentin e krijimit të kësaj marrëdhënie detyrimi. Sa më lart, nënvizohet edhe referuar jurisprudencës së Kolegjit në vendimin nr. 10/2018, për subjektin e rivlerësimit z. ***.***.

23.3 Komisioneri Publik konstaton po ashtu se, si marrja edhe kthimi i kësaj huaje rezulton të jetë kryer jashtë sistemit bankar dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion justifikues ligjor për të vërtetuar marrjen dhe kthimin e saj, përveç deklaratës noteriale të sipërcituar, në referencë kjo të nenit 32/1, të ligjit nr. 84/2016 dhe pikave 15, 18 dhe 21 të Udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016 të ILDKPIKI-së, dalë në zbatim të këtij ligji. Sa më lart, nënvizohet edhe referuar jurisprudencës së Kolegjit në vendimin nr. 7/2018, për subjektin e rivlerësimit z. ***.***, si dhe në vendimin nr.12/2018, për subjektin e rivlerësimit z. ***.***.

⁸ Sipas vërtetimit datë ***.1.2017 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe vërtetimit nga ISSH nr. *** prot., datë ***.7.2018 mbi të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga shoqëria “****” sh.p.k

⁹ Deklaruar në pyetësorin nr. *** , si cituar në paragrafin më sipër.

¹⁰ Subjekti i rivlerësimit gjatë parashtrimeve ka vënë në dispozicion të Komisionit një pasqyrë lëvizjeje të llogarisë së pagës pranë *** Bank, vetëm 1 fletë, nxjerrje llogarie me datë fillimi ***.12.2005 dhe mbarimi datë ***.02.2006, sipas së cilës teprica në datë 31.12.2005 është shuma e deklaruar në vlerën 248.055 lekë. Llogaria rezulton e hapur në emër të Donika *** (mbiemri i vajzërisë). Në dosjen e Komisionit nuk ka asnjë informacion tjetër, as nga subjekti i rivlerësimit dhe as korrespondencë të Komisionit me këtë bankë, mbi gjendjen e kësaj llogarie më datë 31.12.2006, për të verifikuar nëse kjo shumë është tërhequr apo jo. Në mungesë të këtij informacioni, në analizën tonë financiare shuma prej 248,055 lekësh është konsideruar si kursim i vitit 2005 dhe përdorur (bashkuar) me kursimet e deklaruar të vitit 2006.

¹¹ Shiko përgjigjet e pyetësorit nr. ***.

23.4 Lidhur me burimin e ligjshëm të huasë, sjellim në vëmendje përmbajtjen e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet se “...subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”.

23.5 Komisioneri Publik, në interpretim të dispozitave ligjore të mësipërme, si dhe në konsideratë edhe të jurisprudencës të Kolegjit në vendimin nr. 12/2018¹² për subjektin e rivlerësimit z. ***.***, lidhur me vlerësimin si të ardhura të ligjshme të remitancave të pretenduara të emigrantëve, vlerëson se në analizën financiare të shtetasit ***.*** në cilësinë e huadhënësit, duhet të konsiderohen vetëm ato të ardhura për të cilat aktet e administruara¹³ nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, provojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit dhe pagimin e detyrimeve tatimore për to.

23.6 Nga analiza e akteve të paraqitura nga subjekti, të ardhurat e ligjshme të dokumentuara të shtetasit ***.***, deri në momentin e huadhënies së deklaruar, rezultojnë në shumën rreth 2.528.107 lekë¹⁴. Nga dokumentacioni i administruar, rezulton gjithashtu se investimet e kryera nga shtetasi ***.***, deri në vitin 2007 janë në vlerën 3.950.000 lekë¹⁵. Dokumentet e administruara, përfshirë edhe ato të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nuk provojnë mundësinë e krijimit të të ardhurave nga burime të ligjshme të shtetasit ***.***, për të dhënë hua në shumën 15.000 euro.

23.7 Në konkluzion të sa më sipër analizuar, rezulton se, subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, të ardhurat për blerjen e pasurisë nr.1, për një shumë totale prej - 2.562.071 lekë (referoju tabelës nr.2).

Tabela nr. 2 Analiza financiare për pasurinë nr. 1

Mungesa e burimeve financiare të ligjshme në mbulimin e pasurisë nr. 1	Shuma
Mosmbulimi i kursimeve të vitit 2006 (referoju tabelës nr.1)	-285,131
Mosmbulimi i pagesave të vitit 2007 (referoju tabelës nr.1)	- 450,240
Mosmbulimi i huasë nga shtetasi ***.*** me të ardhura të ligjshme	-1,826,700 ¹⁶
Total mosmbulimi i pasurisë nr. 1 me të ardhura të ligjshme	- 2,562,071

23.8 Po ashtu, në të njëjtën deklaratë noteriale të shkurtit 2016, shtetasi ***.***, deklaror po ashtu se në datë ***.6.2010 i ka dhënë shtetasit ***.*** hua edhe një shumë tjetër prej 1.000.000 lekë për efekt të kryerjes së procedurave të pajisjes me vizë të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit. Shuma i është likujduar (kthyer mbrapsht) në datë ***.6.2010 cash nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.

23.9 ILDKPKI, në raportin nr.*** prot., datë ***.12.2018, të hartuar në zbatim të dispozitës së nenit 33, të ligjit nr.84/2016, pas kryerjes së kontrollit të plotë të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, ka konkluduar se subjekti nuk ka deklaruar huamarrjen në

¹² Paragrafi 22 dhe 22.1 i këtij vendimi.

¹³ (i) Vërtetime lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Greqi dhe vërtetim nga Republika e Greqisë Dega C'Vendore e punonjësve të *** nr.prot.*** datë.***.1.2019, sipas së cilit vërtetohet fakti se shtetasi ***.*** ka punuar në shtetin grek dhe ka realizuar të ardhura për të cilat janë paguar detyrimet (sigurimet shoqërore) për total 290 ditë, periudha 1998-2001 në shumën 1,175,000 dhrahmi greke;

(ii) Vërtetime nga Autoriteti Portual Durrës për punësimin e shtetasit ***.***, sipas së cilit ky shtetas për periudhën 2004-prill 2007 ka realizuar të ardhura neto nga pagat në shumën 1.024.972 lekë;

(iii) Vërtetim nga *** me nr. prot *** të datës ***.1.2019, se në datë 31.12.1997, gjendja e depozitës në emër të këtij shtetas ka qenë në shumën 2,464,313 lekë.

(iv) Kontratë e datës ***.4.2003 nr *** Rep nr *** Kol , me objekt shitblerje trualli.

¹⁴ Të ardhurat e siguruara nga emigracioni, sipas vërtetimeve të sipërcituara në vlerën 503.135 lekë, të ardhurat nga paga nga Autoriteti Portual Durrës 2004-prill 2007 në shumën 1.024.972 dhe të ardhurat nga shitja e truallit në vitin 2003 në shumën 1.000.000 lekë.

¹⁵ Blerë apartament në vitin 1998-2001 në shumën 3.800.000 lekë dhe tokë në vlerën 150.000 lekë.

¹⁶ Kundërvlera në lekë e konvertuar me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2007.

shumën 1 milion lekë nga shtetasi ***.*** për efekt të pajisjes me vizë, në DV 2010. Ndërkohë në vendimin e tij, Komisioni ka vlerësuar se nuk ka qënë e nevojshme kryerja e këtij deklarimi sa kohë, në datë 31.12.2010 subjekti nuk ka patur detyrim të pashlyer.

23.10 Në lidhje me aftësinë e shtetasit ***.*** për huadhënie në masën 1.000.000 lekë, nga verifikimi i akteve në dosje, se për periudhën maj 2007 - dhjetor 2009 të ardhurat nga pagat pranë Autoritetit Portual Durrës, janë gjithsej në shumën 1.098.985 lekë. Komisioneri Publik vlerëson se dokumentet e administruara, nuk provojnë mundësinë e krijimit të të ardhurave nga burime të ligjshme të shtetasit ***.***, edhe për të dhënë huanë në shumën 1.000.000 lekë, e cila gjithashtu është dhënë dhe kthyer në *cash*.

24. (iv) Mbi mundësinë e subjektit për shlyerjen e huasë 15.000 euro

24.1 Subjekti në DV të viteve 2008 dhe 2009 ndër të tjera ka deklaruar shlyerjen e huasë në shumat 7,500 euro në dhjetor të vitit 2008 dhe 7,500 euro në dhjetor të vitit 2009.

24.2 Nisur nga deklaratimet e subjektit, është analizuar mundësia financiare për shlyerjen e huasë. Në këtë analizë, janë marrë në konsideratë të ardhurat e ligjshme nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, mbështetur në vërtetimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës datë ***.1.2017, si dhe vërtetimeve nga ISSH nr.*** prot., datë ***.10.2018, dhe nr.*** prot., datë ***.7.2018.

24.3 Për vitin 2008, totali i të ardhurave të ligjshme llogaritet në vlerën 1.874.826¹⁷ lekë. Shpenzimet e vitit 2008 janë në shumën 2.280.523 lekë, në të cilat janë marrë në konsideratë (i) shpenzimet për kapitalin fillestar të shoqërisë “****” sh.p.k, themeluar nga bashkëshorti i subjektit si dhe shpenzimet tatimore lidhur me këtë shoqëri, të deklaruara nga ky i fundit, (ii) shlyerja e huasë në vlerën 7.500 euro konvertuar me kursin e fundvitit 2008, (iii) shpenzimet për blerje automjeti, (iv) shpenzimet e jetesës sipas përbërjes familjare si dhe (v) ndryshimet e likuiditeve në llogaritë bankare të pagave të subjektit dhe bashkëshortit të saj.

24.4 Nga analiza rezulton se subjekti nuk mbulon me të ardhurat të ligjshme në kuptim të nenit D pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, shpenzimet e vitit 2008 përfshirë dhe shlyerjen e deklaruar të huasë për vlerën - 405,697 lekë.

25. Në vlerësim të sa më sipër, konstatojmë se nuk është shpjeguar bindshëm burimi i ligjshëm i të ardhurave të huadhënësit ***.***. Gjithashtu, rezulton se subjekti nuk ka burime financiare të ligjshme për të shlyer huanë në vitin 2008.

26. Pasuria nr. 2, likuiditetet/llogari bankare në shumën 4.501.427,89 lekë

26.1 Në deklaratën “vetting” subjekti ka deklaruar: Llogari bankare në shumën 4.501.427,89 lekë, pranë ***, në emër të z. ***.***. Kjo llogari bankare është krijuar nga (i) shitja e apartamentit me sip.59.2 m², në lagjen nr.***, *** ***, si dhe (ii) kursimet nga paga e të dy bashkëshortëve gjatë viteve, depozituara në bankë më datë ***.2.2016.

26.2 (i) Në DV 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Blerje apartamenti me sipërfaqe 59.2 m² në lagjen nr.*** ***, ***, në vlerën 1,400,000 lekë, me anë të kontratës nr. *** rep., nr.*** kol., e datës ***.2.2014, në shumën 1.400.000 lekë.

Burimi i krijimit: “Kursime nga të ardhurat e krijuara në vitin 2015 përfshirë dhe ato të deklaruara në vitin 2014 dhe më parë 1.200.000 lekë gjendje *cash*. Sqarojmë se nga kursimet është realizuar blerja e apartamentit.” Subjekti në të njëjtën deklaratë ka deklaruar: “shitja e apartamentit të mësipërm me vlerën 4.000.000 lekë.”

26.3 Referuar përmbajtjes së kontratës së blerjes së kësaj pasurie, në cilësinë e palës blerëse rezulton z. ***.*** dhe palës shitëse, ish-punëdhënësi i tij, shoqëria “****” sh.p.k.

¹⁷ Konsideruar këtu dhe e ardhura nga shitja e automjetit.

Regjistrimi fillestar i kësaj pasurie në emër të shoqërisë “****” sh.p.k, rezulton në datën ***.1.2014. Konstatohet se çmimi i blerjes së këtij apartamenti në vlerën 1.400.000 lekë rezulton ndjeshëm më i ulët jo vetëm se çmimet e referencës së zonës ku ndodhet pasuria, por edhe nën koston e ndërtimit¹⁸. Ky apartament rezulton të jetë blerë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në vlerën 23.648 lekë/m².

26.4 Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetjeve të Komisionit mbi diferencën e çmimit, ka pretenduar se ky çmim është dhënë në vlerë të tillë, referuar marrëdhënies së punës midis bashkëshortit të saj dhe administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k dhe një marrëveshje verbale mes tyre. Për të vërtetuar këtë fakt, Komisioni ka administruar përgjigjen e shoqërisë “****” sh.p.k, me nr.*** prot., datë ***.9.2018, në të cilën administratori i kësaj shoqërie shprehet se “... çmimi i përcaktuar në vlerën 10.000 euro (1.4 milion lekë) nuk është çmim favorizues por çmim i përcaktuar me marrëveshje verbale për shkak të punësimit të ***,*** si inxhinier ndërtimi në objektin ku ndodhet apartamenti.” Në të njëjtën deklaratë, administratori i shoqërisë, sqaron se sipas marrëveshjes që kam patur me shtetasin ***,***, nëse ai do të qëndronte deri në përfundim të ndërtimit të objektit, apartamenti do ti llogaritej si vlerë e pagesës së punës së kryer krahas pagës neto me 100.000 lekë/muaj. Meqënëse në muajin dhjetor 2011 ai është larguar nga drejtimi i punimeve, është përcaktuar çmimi i shitjes prej 10.000 euro.”

26.5 Nga verifikimi i akteve në dosje, rezulton se në kontratën e punës lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k dhe z. ***,***, datë ***.8.2010, nuk parashikohen kushtet e mësipërme të pretenduara nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe provave të paraqitura gjatë procesit të rivlerësimit.

26.6 **Lidhur me burimin e krijimit të këtij apartamenti**, analiza bazohet në mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të realizuar kursimet *cash* të deklaruara që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë nr.2. Në analizë financiare janë konsideruar si të ardhura të ligjshme të subjekti dhe personit të lidhur/bashkëshortit vetëm ato të ardhura të konfirmuara nga burimet zyrtare, në kuptim të nenit D pika 3 të aneksit të Kushtetutës, duke iu referuar të njëjtit interpretim ligjor të parashtruar më lart për pasurinë nr.1. Në shpenzimet e subjektit janë përfshirë (i) shpenzimet e jetesës për familjen e saj, bazuar në përlllogaritjet e përdorura nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni, mbështetur në të dhënat e INSTAT-it, (ii) shpenzimet për mobilim të apartamentit në Tiranë sipas deklaratave të vetë subjektit në pyetësorët e Komisionit, (iii) pagesat për studime master duke përfshirë dhe rimbursimin e shumës sipas deklaratave të subjektit, (iv) shpenzimet e udhëtimit sipas të dhënave të sistemit TIMS, si dhe (v) shpenzimet e deklaruara nga bashkëshorti i saj për pagesën e detyrimeve tatimore të shoqërisë “****” sh.p.k.

26.7 Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, rezulton se kursimet e përdorura si burim për blerjen e kësaj pasurie datojnë nga DV 2010. Në DV 2010 subjekti ka deklaruar kursime të krijuara nga të ardhurat nga paga e saj dhe bashkëshortit, në vlerën 500.000 lekë.

26.8 Në analizën financiare të vitit 2010, janë marrë parasysh si të ardhura të ligjshme vetëm të ardhurat e subjektit të rivlerësimit sipas vërtetimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës datë ***.1.2017, pasi ISSH me shkresën nr. *** datë ***.7.2018 lidhur me të ardhurat e bashkëshortit, konfirmon se *për periudhën shkurt 2009-dhjetor 2011, emri i kërkuar* (i bashkëshortit të subjektit) *nuk figuron në listpagesa*.

26.9 Të ardhurat e ligjshme të vitit 2010 rezultojnë në shumën 908,684 lekë. Kursimi prej 500,000 lekë nuk mbulohet me të ardhura të ligjshme, duke llogaritur këtu dhe kostot e

¹⁸ Referuar udhëzimit nr. 1 datë 8.5.2013 të EKB-së, çmimi i shitjes është 74.000 lekë/m², ndërsa kostoja e ndërtimit, sipas të njëjtit udhëzim rezulton në vlerën 36.203 lekë/m².

jetesës dhe shpenzimet e tjera vjetore, për një diferencë negative prej -319,128.64 lekë (referoju tabelës nr. 3).

26.10 Në DV 2011, subjekti ka deklaruar: “Shtuar kursime të deklaruar në DV 2011 në shumën 1.500.000 lekë cash, burimi të ardhurat nga puna ime dhe e bashkëshortit.”

26.11 Të ardhurat e ligjshme të subjektit dhe bashkëshortit të saj për vitin 2011 janë në shumën 1,274,227 lekë¹⁹, ndërkohë kursimi i deklaruar është në shumën 1.500.000 lekë. Kursimi prej 1.500,000 lekë nuk mbulohet me të ardhura të ligjshme, duke llogaritur këtu dhe kostot e jetesës dhe shpenzimet e tjera vjetore, për një diferencë negative prej - 1.260.035 lekë (referoju tabelës nr. 3).

26.12 Në DV 2012-2013, subjekti ka deklaruar: Kursime të realizuara në vitet paraardhëse, gjendje cash 2.000.000 lekë.

26.13 Në konkluzion të sa më sipër, rezulton se subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shtesat në kursimet cash të deklaruar në vitet 2010 dhe 2011 (referoju tabelës nr. 3).

Tabela nr. 3 Analiza financiare bazuar në të ardhurat e ligjshme për të cilat rezulton se janë paguar detyrimet tatimore për vitet 2010 - 2011.

	Viti 2010	Viti 2011
Të ardhura SR (I)	908,684	989,558
Të ardhura bashkëshorti (II)	0	284,669
Kursime të deklaruar (III)	500,000	1,500,000
Shpenzime (IV)	833,040	908,908
Ndryshime të llogarive bankare (V)	-105,227	125,354
Diferenca (VI=I+II-III-IV-V)	-319,128	-1,260,034

26.14(ii) Lidhur me diferencën e depozituar në llogarinë bankare, e deklaruar: “me kursimet nga paga e të dy bashkëshortëve gjatë viteve të depozituara në bankë më ***.2.2016”, rezulton se diferenca e depozituar, e deklaruar me burim kursime nga pagat, mbulohet me të ardhura të ligjshme.

Transaksione të padeklaruar

27. Mosdeklarimi i huasë prej 25.000 euro.

27.1 Referuar “Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit D. Prela” të ILDKPKI-së me nr. *** prot., datë ***.2.2018, përgatitur në zbatim të nenit 33 të ligjit nr.84/2016, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti i saj z. ***.*** nuk kanë deklaruar një marrëdhënie huaje në shumën totale prej 25.000 euro në DV e vitit 2011, ashtu edhe kthimin (marrjen) e shumës 25.000 euro në DV 2014.

27.2 Mbi ekzistencën e kësaj marrëdhënie huaje dhe mosdeklarimit të saj nga subjekti i rivlerësimit, nga aktet në dosjen e Komisionit, rezulton se ILDKPKI-ja është vënë në dijeni nga një komunikim zyrtar me Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit të Parave (DPPP), ku kjo e fundit me anë të shkresës nr.*** prot., datë ***.5.2017, ka referuar se

¹⁹ Sipas vërtetimit të Prokurorisë Durrës datë ***.1.2017, mbi të ardhurat e subjektit; dhe të ardhurat e bashkëshortit të saj konfirmuar me shkresat e ISSH-së nr. *** prot., datë ***.10.2018, i punësuar pranë shoqërisë “***.***” sh.p.k. për periudhën 6/2011-12/2011; shkresa nr. *** prot., datë ***.10.2018, i punësuar pranë Bashkisë Tiranë për periudhën 11/2011-12/2011; Vërtetim Bashkia Durrës Komuna *** datë ***.10.2016, verifikuar me nxjerrje llogarie nga ***; shkresa nr. *** datë ***.7.2018 lidhur me të ardhurat e bashkëshortit, konfirmon se për periudhën shkurt 2009-dhjetor 2011, emri i kërkuar (i bashkëshortit të subjektit) nuk figuron në listpagesat e shoqërisë “***” sh.p.k.

për z. ***.*** është identifikuar një transaksion bankar, tërheqje *cash* në shumën 20.000 euro më datë ***.6.2014, në llogarinë e tij pranë “**** Bank”.

27.3 “**** Bank” i ka referuar ILDKPKI-së se, shtetasi ***.*** ka qenë përfitues i një shume nga kredia e miratuar nga kjo bankë për subjektin “***.***” sh.p.k (një ndër ish-punëdhënësit e z.***.*** me administrator z. ***.***. Për të shmangur rrezikun që kjo kredi të mos përdorej jashtë objektit të saj, disbursimi i limitit të kredisë të miratuar për “***.***” shpk, do të kryhej direkt nga banka në llogari të palëve të treta (huadhënësve), përfshirë këtu dhe në llogarinë e shtetasit ***.***, për të mbyllur ekspozimet që ka patur shtetasi ***.***²⁰, kundrejt tyre.

27.4 Referuar lëvizjeve të llogarisë bankare të shtetasit ***.***, të konfirmuara nga “****” Bank me shkresën nr. *** datë ***.6.2017, rezulton se në datë ***.6.2014 është disbursuar shuma prej 25.000 euro, e cila është tërhequr 5.000 euro në datë ***.6.2014 dhe 20.000 euro në datë ***.6.2014 nga z.***.***. Në korrespondencën me ILDKPKI “**** Bank” ka vënë në dispozicion gjithashtu edhe:

- Deklaratën Noteriale me nr.*** rep., nr. *** kol., datë ***.9.2011, të deklaruesve ***.*** dhe ***.***, ku ***.*** deklaron se “*marrë hua me datën e sotme nga ***.*** shumën 10.000 euro, për një periudhë një vjeçare duke filluar nga data e sotme, ***.9.2011 dhe deri më ***.9.2012 me një interes mujor në masën 2%*”.
- Deklaratë shkresore e datës ***.9.2011, nënshkruar nga ***.*** dhe ***.***, ku ***.*** deklaron se i ka marrë hua në datën e nënshkrimit të kësaj deklarate ***.*** shumën 15.000 euro, për një periudhë *një vjeçare me interes mujor 2%*. Nënshkrimet në këtë deklaratë janë vërtetuar sipas ligjit nga noteri publik ***.*** më datë ***.10.2013.
- Marrëveshje shtesë e Kontratës për Kufi Kredie Shumëqëllimore²¹ me nr. *** rep., nr. *** Kol., e datës ***.6.2014 ndërmjet “**** Bank” (kredidhënësi) dhe ***.*** (kredimarrësi).

27.5 Gjatë hetimit administrativ, Komisioni me anë të pyetësorit nr. ***, ka kërkuar nga subjekti i rivlerësimit të dhëna mbi burimin e shumës së dhënë hua prej 25.000 euro dhe dokumentimin e procesit në lidhje me dhënien dhe kthimin e kësaj huaje. Në përgjigje të këtij kërkimit të Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*...Për sa i përket huasë që bashkëshorti im ka dhënë borxh në vitin 2011 shtetasit ***.*** në shumën 25.000 euro, pasi u njoha me pyetjen e bërë nga ana juaj, nga komunikimi me bashkëshortin ***.***, erdha në dijeni se këtë shumë bashkëshorti im e ka dhënë hua duke vepruar si përfaqësues me prokurë i shtetasit ***.***, kushëriri i tij. Kjo shumë nuk është pasuri e cila i përket bashkëshortit tim ***.*** apo na përket ne si familje. Konkretisht për shkak të marrëdhënies së posaçme punëdhënëse, punëmarrës që bashkëshorti im ***.*** ka patur me shtetasin ***.*** si administrator i shoqërisë “***.***” sh.p.k, në vitin 2011 shtetasit ***.*** dhe shtetasi ***.***, djali i xhaxhait të bashkëshortit, kanë biseduar që ky i fundit ti jepte hua shumën 25.000 euro”.*

27.6 Në mbështetje të deklaratës së mësipërme subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit:

- Prokurën e posaçme noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.7.2011, me anën e së cilës ***.*** ka caktuar si përfaqësues ligjor të tij ***.***;
- Deklaratë Noteriale nr. *** Rep., nr. *** Kol., datë ***.9.2018 e z. ***.***;
- Deklaratë Noteriale nr.*** Rep., nr. *** Kol., datë ***.9.2018 e z.***.***.

²⁰ Referuar edhe nenit 3 të Kontratës për Kufi Kredie Shumëqëllimore me nr. *** Rep., nr. *** Kol., datë ***.6.2014, me kredimarrës ***.***.

²¹ Në vijim të Kontratës për Kufi Kredie Shumëqëllimore me nr. *** Rep.../2014.

27.7 Lidhur me burimin e shumës së dhënë hua, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion disa dokumenta fotokopje të përkthyer dhe noterizuara mbi qëndrimin e shtetasit ***.*** në shtetin italian si dhe të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja e tij nga punësimi në këtë shtet.

27.8 Në vlerësim të fakteve të mësipërme, Komisioni ka konkluduar se “... *Këto veprime, z. ***.***, i ka kryer me prokurën e posaçme të datës ***.7.2011, të deklaruar edhe në DPV përkatës. Po ashtu është deklaruar dhe dokumentuar nga hetimi se shtetasi ***.*** ka patur burime financiare të mjaftueshme dhe nga burim i ligjshëm, për dhënien e kësaj huaje shtetasit ***.*** (administrator i shoqërisë “***.***” sh.p.k) ku z. ***.*** ka qenë i punësuar. Huadhënia nuk është deklaruar, pasi nuk ka qenë pjesë e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj²²”.*

27.9 Nga analiza e akteve në dosje, referuar dhe raportit të ILDKPKI-së, Komisioneri Publik konstaton se marrëdhënia e huasë mes bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit ***.***, qofte edhe referuar prokurës së posaçme të korrikut 2011, nuk rezulton të jetë deklaruar në asnjë prej deklaratave periodike vjetore 2011-2014 apo deklaratën vetting. Prokura nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.7.2011 është administruar si akt, vetëm gjatë hetimit administrativ të Komisionit, megjithëse daton korrik 2011. Gjithashtu konstatohet se dy deklaratat noteriale, ajo e z. ***.*** dhe e z. ***.***, janë hartuar pas njohjes së subjektit me rezultatet e hetimit administrativ, të dyja në datë ***.9.2018.

27.10 Referuar Deklaratave noteriale të shtatorit 2011, rezulton se afati i huasë është një vjeçar dhe me interes mujor 2%. Ndërkohë sipas nxjerrjes së llogarisë të shtetasit ***.***, vënë në dispozicion nga “*** Bank” dhe sipas deklarimeve të pyetësorin nr. ***, rezulton se bashkëshorti i saj ka qenë palë kreditore në këtë marrëdhënie deri në qershor të vitit 2014 (pra për gati tre vjet), kur është bërë dhe kthimi i shumës 25.000 euro në llogarinë bankare në emër të tij në “*** Bank”.

27.11 Sa më sipër, në cilësinë e huadhënësit, referuar akteve ligjore (deklaratë noteriale, deklaratë shkresore vërtetuar nënshkrimi nga noteri publik) rezulton se personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe palët deklaruese në asnjë moment nuk deklarojnë faktin se huadhënësi ***.*** po vepron në emër të ***.***, sikurse shprehet prokura e posaçme e korrikut 2011.

27.12 Në vlerësim të Komisionerit Publik rrethanat e mësipërme juridike dhe pozita juridike e kreditorit që kishte z. ***.*** duhet të deklaroheshin nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/bashkëshorti i saj, në zbatim të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar si dhe dispozitave të ligjit nr.84/2016, duke bashkëngjitur dhe dokumentin ligjor, prokurën e posaçme, mbi bazën e të cilit sqarohet burimin i krijimit të shumës, shkakun pse e posedonin atë dhe faktin se vepronin në emër të një personi të tretë.

27.13 Deklarata e Interesave Private Periodike/Vjetore, në faqen 11 të saj, rubrika mbi të dhënat konfidenciale, ndër të tjera ngarkon subjektet deklaruese me përgjegjësinë ligjore për deklarimin me korrektesi dhe vërtetësi mbi të dhënat konfidenciale në lidhje me identitetin e personit juridik ose fizik huadhënës a huamarrës, emërtesën e institucionit publik ose privat me të cilët ka marrëdhënie interesi, duke specifikuar kështu edhe dokumentin ligjor mbi bazën e të cilit rregullohet kjo marrëdhënie.

27.14 Lidhur me dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës 25.000 euro, konstatohet se dokumentet e paraqitura nga subjekti i

²² Referuar prg. 95, 96 dhe 97 të vendimit të Komisionit.

rivlerësimin mbi të ardhurat e ***.*** nuk kanë elementet e nevojshme formale të domosdoshme për provueshmërinë dhe vlefshmërinë e tyre. Referuar kërkesave të KPrC dhe legjisllacionit në fuqi, ato paraqiten fotokopje të përkthyer dhe noterizuar përkthimi, pa vulë apostile²³.

28. Transaksion bankar/pagesë cash në shumën 1.755.000 lekë, viti 2013, kryer nga z. ***.***

28.1 Nga “Akti përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Donika Prela”, i ILDKPKI-së, me nr. *** prot., datë ***.2.2018, përgatitur në zbatim të nenit 33 të ligjit nr.84/2016, rezulton gjithashtu²⁴ se me anë të shkresës nr.*** prot., datë ***.5.2017, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit të Parave (DPPP), informon ILDKPKI-në se për z.***.*** është identifikuar një transaksion bankar i datës ***.4.2013 në shumën 1.755.000 lekë i kryer pranë ***.***.*** (***.*** Bank), me përshkrim veprimi: kreditim llogarie.

28.2 Lidhur me këtë transaksion, nga banka sqarohet se veprimi është kryer ndërmjet ***.*** dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme me nipt ***. Burimi i të ardhurave të deklaruara për efekt të transaksioit: shitja e apartamenteve. Më tej sqarimi vijon se: “Veprimet janë kryer në sportelin e Bankës pranë ZRPP Durrës”²⁵.

28.3 Komisioni, me shkresën nr.*** prot., datë ***.10.2018 ka kërkuar informacion nga “*** Bank”, dhe kjo e fundit me shkresën nr.*** prot., datë ***.11.2018, ka vënë në dispozicion të Komisionit (i) mandat arkëtimin e datës ***.4.2013 për derdhjen e shumës 1.755.000 lekë nga z. ***.*** në favor të ZRPP Durrës, (ii) deklaratën e burimit të të ardhurave plotësuar në datë ***.4.2013, ku në seksionin mbi deklarimin e burimit të shumës së depozituar është shkruar nga z.***.*** me shkrim dore: “shitja e apartamenteve nga ***.***, (administrator i firmës)”, si dhe (iii) kopjen e mjetit të identifikimit të shtetasit ***.***.

28.4 Nga aktet e administruara nuk provohet lidhja, shkak ligjor dhe qëllimi i kryerjes së transaksionit nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimin pranë ZVRPP Durrës, në muajin prill të vitit 2013, periudhë në të cilën bashkëshorti i subjektit ka qënë i punësuar pranë Bashkisë Tiranë, ndërkohë që marrëdhëniet e punësimit me shoqërinë “****” sh.p.k., ishin ndërprerë prej nëntorit të vitit 2011²⁶.

29. Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se për kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimin ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe jo në përputhje me ligjin, në kuptim të pikës 3, 5 të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “a” dhe nenit 61, pika 3, 5 të ligjit nr. 84/2016.

II. B. Vlerësimi i aftësive profesionale

30. Në zbatim të nenit E të aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, Komisioni pasi ka administruar dhe analizuar raportin mbi vlerësimin e aftësive

²³ Në këtë drejtim mbajmë në konsideratë edhe praktikën e KPA-së, vendimi nr. 9/2018, për subjektin e rivlerësimin znj.***.***.

²⁴ Faqe 14 dhe 15 e këtij raporti.

²⁵ Sipas deklarimeve të ZRPP Durrës qëllimi i transaksioneve ka qënë:

Regjistrim përfundimtar i ndërtimeve të reja të Firmës *** shpk për: 195 njësi x 6.500 lekë = 1.267.500 lekë

Lëshim vërtetim pronësie për: 195 njësi x 1.500 lekë = 292.500 lekë

Lëshim harta treguese për: 195 njësi x 1.000 lekë = 195.000 lekë

Totali = 1.755.000 lekë.

. është administrator i shoqërisë “****” sh.p.k. Dokumentat që disponojmë janë mandat arkëtimi dhe dokumenti i identifikimit të ***.***.***, Formulari i deklarimit të burimit të të ardhurave dhe formulari i aplikimit në ZRPP Durrës.

²⁶ Fakt i konfirmuar nga ***.*** në dokumentin e protokolluar pranë Komisionit me nr. prot *** datë ***.9.2018.

profesionale të subjektit të rivlerësimit, përgatitur nga Prokuroria e Përgjithshme, ka konstatuar se për dy nga pesë dosjet penale e përzgjedhura, dy çështje të ndjekura nga subjekti (dosja nr. *** dhe ***) që kanë pasur për objekt të njëjtën vepër penale, atë të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal “*Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt*”, janë ndjekur standarde të ndryshme hetimi. Në rastin e dosjes nr.***, për të pandehurin shtetasin ***.*** është proceduar në kushtet e masës së sigurimit “arrest në burg”, ndërsa për dosjen nr.***, i pandehuri ***.*** për të njëjtën vepër penale është proceduar në gjendje të lirë, pa u kërkuar masë sigurimi nga ana e prokurorisë. Njëkohësisht me gjetjet nga raporti i vlerësimit profesional, Komisioni ka hetuar edhe raste të denoncimeve nga publiku dhe media, për të cilat është marrë qëndrimi i subjektit, administruar edhe gjetjet e ONM-së dhe përfundimisht, Komisioni ka pranuar të konkludojë nga sa është argumentuar nga subjekti i rivlerësimit dhe rezultatet e hetimit të kryer për denoncimet e publikut.

II.C. Kontrolli i figurës

31. Bazuar në nenin DH të aneksit të Kushtetutës dhe kreun V të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi administrativ i Komisionit nuk janë gjetur elementë që të vërtetojnë apo ngrenë dyshime të arsyeshme mbi kontakte të papërshtatshme të subjektit. Në dosjen e hetimit administrativ të Komisionit është administruar raporti i hartuar nga DSIK, përcjellë Komisionit me shkresën nr.***, datë ***.11.2017, ku konkludohet për përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit. Po ashtu janë administruar nga Komisioni edhe raportet e ShISH të muajit dhjetor 2017 dhe nëntor 2018. Sipas Komisionit, në analizë të të gjitha të dhënave të administruara dhe akteve të mësipërme shkresore, subjekti i rivlerësimit është gjendur në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës.
32. Në funksion të kërkimi të ankimit, Komisioneri Publik, nisur nga roli që Kushtetuta i njuh si përfaqësues i interesit publik në procesin e rivlerësimit, referuar instrumentit procedural (ankim) që Kushtetuta i ka njohur për të aktivizuar juridiksionin kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit, në rastet kur kërkohet ndryshimi i vendimit të konfirmimit për subjektin e rivlerësimit, vendim ky (konfirmimi në detyrë) që nga organet e rivlerësimit (Komisioni dhe mbi ankimin e Komisionerit, Kolegji) merret vetëm pas çmuarjes njëkohësisht të secilit prej kritereve (pasuri, profesionalizëm, figurë), në mënyrë të pavarur dhe pas vlerësimit tërësor të tyre, çmon se juridiksioni i Kolegjit në kontrollin/rivlerësimin e vendimit të Komisionit, do të duhet të ushtrohet për të tre kriteret e rivlerësimit.
33. Në këtë mënyrë, si një ndër burimet e provës të parashikuara nga ligji nr. 84/2016, denoncimet e publikut, por jo vetëm, mund të shërbejnë për rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit në të tri kriteret e përcaktuara në Kushtetutë dhe eventualisht konfirmimin ose jo të subjektit të rivlerësimit, deri në momentin që vendimi i Komisionit ende nuk përbën *res judicata* në tërësinë e tij, për shkak të ushtrimit të ankimit të Komisionerit Publik. Juridiksioni kontrollues/rivlerësues që i njihet Kolegjit dhe zhvillimi i gjykimit të ankimit të Komisionerit Publik në seancë publike, duke i dhënë të gjitha të drejtat për t’ u dëgjuar dhe për t’ u mbrojtur subjektit të rivlerësimit, do të garantonin në çdo rast respektimin e elementëve të procesit të rregullt ligjor.

III. Kërkimi i ankimit

34. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri

Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e saj në detyrë;

35. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;
36. Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit;
37. Bazuar në nenin Ç, D dhe F, të aneksit të Kushtetutës, neneve 30-34, pikës 3, 5 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;
38. Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:
 - Ndryshimin e vendimit nr. 103, datë 5.2.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, zonjës Donika Prela.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA